



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 33
Prishtinë, më 13 dhjetor 2018, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Mërgim Lushtaku, Albert Kinolli, Valon Ramadani, Avdullah Hoti, Andin Hoti, Emilija Rexhepi, dhe Ali Lajçi.

Munguan: Faton Topalli, Etem Arifi dhe Verica Qeraniq.

Stafi mbështetës: Mehmet Simnica, Ajet Avdullahu dhe Endrit Rustemi.

I ftuar: Endrit Shala, ministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Pjesëmarrësit e tjerë: Durim Limaj, Haki Maxhuni, Durim Rreci dhe Nysret Vojvoda nga MTI, Vjoleta Smajlaj, Samir Symberi e Emine Fazliu nga ZKA-ja dhe Pajtime Sadiku nga KDI-ja.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.11.2018;**
- 3. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017;**
- 4. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve nga raporti i auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh. a, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.11.2018

Procesverbali i mbledhjes, të mbajtur më 20.11.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

Driton Selmanaj i njoftoi deputetët që i ftuar në mbledhje është ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, z. Endrit Shala, me të cilin do të diskutojnë Raportin e Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017. Ai, po ashtu, njoftoi që deputet raportues për këtë mbledhje është Avdullah Hoti, të cilit edhe i dha fjalën të bëjë një prezantim të shkurtër lidhur me të gjeturat e auditorit.

Avdullah Hoti tha se Opinioni i Auditorit për këtë Raport është Opinion i kualifikuar me Theksim të Çështjes. Çështja që është kualifikuar është mos prezantimi i detyrimeve kontingjente në shumë prej 1.9 milion euro. Kjo lidhet me punën e Avokaturës Shtetërore, ku janë gjithsej 31 lëndë dhe duket që nuk ekziston një komunikim i mirë me Avokaturën Shtetërore. Ndërsa baza për opinion është prezantimi i huamarrjeve në pasqyrat financiare vjetore të ministrisë, që në fakt ato prezantohen në nivel të Qeverisë. Ai tha që vlerësimi i Auditorit është që buxheti nuk është shpenzuar në nivelin e pritur dhe se 79% të shpenzimeve kapitale kanë ndodhur në tremujorin e fundit të vitit 2017. Të gjeturat tjera të Auditorit janë planifikimi dhe menaxhimi i të hyrave, ku ministria planifikon të hyra në bazë të departamenteve dhe jo sipas llojeve të të hyrave dhe nuk ka një rregullore të brendshme për këtë. Pastaj kemi anashkalim të procedurave të prokurimit, zgjatje e të kontratave për shërbime të veçanta të cilat kanë zgjatur më shumë se 6 muaj. Ai tha që ka ende dobësi në prokurim ku auditori ka gjetur disa kontrata me vlerë minimale të cilat përsëriten gjatë vitit. Ai gjithashtu tha se ka një vonesë në zbatimin e rekomandimeve nga vitet paraprake, por gjithashtu ka një përmirësim sa i përket qeverisjes së mirë, mirëpo që auditori ngrit theksin për një planifikim shumë më të mirë të shpenzimeve kapitale. Ai në fund përmendi edhe mos funksionimin e duhur të Njësinë e Brendshme të Auditimit, e cila nuk kishte përgatitur plan për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2016.

Endrit Shala tha që kanë bërë një renditje të rekomandimeve të Auditorit dhe se do ta njoftojë Komisionin për të gjitha zhvillimet sa i përket zbatimit të rekomandimeve. Ai tha se sa i përket pagesave të zyrtarëve për koeficientet e ndryshëm të pagesave, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka marrë të gjitha veprimet e nevojshme për harmonizimin e të gjitha pozitave, por që Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Financave nuk i ka përfillur kërkesat e tyre. Ai tha që MTI është përkujdesur që pozitat për marrëveshjet për shërbimeve të veçanta të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për rekomandimi për llojet e të hyrave të planifikimi dhe realizimi i të hyrave ai tha që kjo kërkesë do t'u adresohet udhëheqësve të linjave buxhetore, si dhe u zotua që ky rekomandim të realizohet në afatin më të shpejtë të mundur. Në fushën e subvencioneve ku Auditori ka gjetur dobësi në dhënien dhe monitorimin e subvencioneve, ai tha që projektin me UNDP, ata kanë dërguar një shkresë në MTI, ku kanë deklaruar që fondet që jepen nga ata nuk lejohen të auditohen.

Andin Hoti përmendi çështjen e anulimit të konkurseve, si dhe pyeti rreth rekomandimeve të vitit 2016, se a ka bërë MTI ndonjë plan veprimi për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Emilija Rexhepi pyeti se sa MTI e respekton ligjin për punësimin e komuniteteve pakicë i cili thotë që 10% e të punësuarve duhet të jenë nga komunitetet pakicë, si dhe lidhur me subvencionet ajo tha që komuniteti boshnjak nuk ka përfituar shumë grante nga ministria dhe pyeti ministrin se çka do të ndërmerret për të përmirësuar këtë gjendje.

Mërgim Lushtaku pyeti rreth çështjes së të hyrave se pse janë planifikuar në këtë mënyrë. Ai tha që në vitin 2017 ishte bërë planifikimi më i ulët që të bëhet realizimi më pozitivisht. Po ashtu ai tha që realizimi i buxhetit është shumë i dobët. Ai në fund pati një pyetje për ministrin për kontrollin e cilësisë së naftës.

Driton Selmanaj tha që Ligji për shërbyesit civilë thotë që nuk mund të jetë më shumë se 3 muaj një pozitë me ushtrues detyre. Sipas Auditorit në MTI janë rreth 11 pozita të cilat mbahen me ushtrues detyre të cilat janë zgjatur nga 12 e deri në 18 muaj. Ai pyeti Ministrin se pse ka ndodhur kjo gjë. Ai gjithashtu pyeti rreth kontratave për shërbime të veçanta, ku Ministria ka angazhuar 20 persona dhe 12 prej tyre janë angazhuar me tepër se 6 muaj, si dhe këto pozita mbahen për pozita të rregullta, e që kjo bie në kundërshtim me ligjin. Ai gjithashtu shtoi që ka edhe dobësi në prokurim, ku në kontratat me vlerë minimale janë përsëritur për blerjet të ngjashme. Ai pyeti ministrin se a po vjen kjo si rezultat i keq planifikimit apo po doni t' i shmangni procedurat e prokurimit.

Endrit Shala tha që për pozita të larta tani është vetëm dy pozita të cilat mbahen me ushtrues detyre dhe njëra prej tyre është për shkak të një procedure gjyqësore. Për kontratat për shërbimet e veçanta ai tha që do të kujdeset që këto mangësi të mos përsëriten.

Albert Kinolli tha qëllimi i komuniteteve pakicë është të integrohen dhe që komuniteti rom gjithmonë ka kërkuar vetëm trajtim të barabartë dhe asgjë më shumë. Ai tha ndihet mirë që janë rreth 27 pjesëtarë të komunitetit pakicë si pjesë e KIESA-së, por që nga komuniteti rom nuk ka asnjë pjesëtarë aty. Ai pyeti ministrin nëse mund t' ua dërgojë listën e të punësuarve të pjesëtarëve të komuniteteve në KIESA dhe Inspektorat. Ai gjithashtu shtoi që lidhur me subvencionet të përkrahen komunitetet dhe kur të kenë të bëjnë me kërkesat e tyre të bëhet një trajtim më i veçantë.

Përfundim

KMFP vendosi që Raportin e Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të audituara të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vitin 2017 të mos adresohet për seancë Plenare.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve nga raporti i auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh. a, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

Avdullah Hoti propozoi që kudo që shkruhet “Kryesues i Bordit” të shkruhet “Bordi” sepse bordi vepron si trup. Ai po ashtu te pika C propozoi të ndryshohet dhe të fshihet pjesa ku përmendet ATK.

Ai gjithashtu tha që komisioni nuk ka nevojë që për çdo raport të nxjerrë rekomandime sepse ato që po i nxjerrim pothuajse në 90% të rasteve janë të njëjta me rekomandimet e Auditorit.

Driton Selmanaj propozoi që pika 2, që ka dalë nga diskutimet e takimet dhe që i adresohet Qeverisë, të mos përfshihet në rekomandime. Ai gjithashtu tha nuk kemi nevojë që me i përsëritë rekomandimet e Auditorit, por vetëm në rastet kur kemi të shtojmë ndonjë rekomandim përtej atyre të Auditorit.

Përfundim

KMFP vendosi që të miratojë rekomandimet për raportin e auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh. a, së bashku me vërejtjet e paraqitura. Të njëjtat vendosi të i adresohen Bordit dhe Menaxhmentit të Trainkos Sh. a.

5. Të ndryshme

Driton Selmanaj i njoftoi deputetët që mbledhja e komisionit e paraparë më 17 dhjetor për të shqyrtuar Raportin e Ministrisë së Shëndetësisë nuk do të mbahet për shkak të angazhimeve që kam të hënën, andaj administrata do të përkujdeset që në koordinim me administratën e ministrisë që ky takim të mbahet të mërkurën ose ndonjë ditë tjetër gjatë javës.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Driton Selmanaj